

Fillimi > -Kronikë

Shkëmbimi i zjarrit në Elbasan, pas “korçarit” arrestohen edhe dy të rinj, zbardhen rolet e tyre në ngjarje (Emrat)

26 Nëntor, 2020 10:28 | 3 505 shfletime



Madhësia e tekstit:

- Policia e Elbasanit ka arrestuar dy persona të tjerë, të përfshirë në shkëmbimin me armë zjarri një ditë më parë, në këtë qytet.
- Në pranga kanë rënë dy të rinjtë F. F., 21 vjeç, dhe E. C., 21 vjeç,, si dhe është shpallur në kërkim 21-vjeçari A. C., i akuzuar për veprat penale “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Armëmbajtja pa leje”.

Gazetarja Dorjana Bezat raporton për **“BalkanWeb”** se të arrestuarit janë Feliks Filja, i cili ka qenë në mjet me Elvis Koçi (Çaushllari), dhe Ersi Cekani, që ka larguar nga vendngjarja Elvisin dhe Feliksin, ka siguruar mjetin dhe ka transportuar në Spital në Tiranë Elvisin.

Ndërkohë, i shpallur në kërkim është Armand Cevoli, pronari i mjetit “Ford Focus”, me të cilin udhëtonte Migert Qosja.

Kujtojmë se një ditë më parë u arrestua te Spitali i Traumës, ku po merrte trajtim mjekësor pas plagosjes, Elvis Koçi (Çaushllari), 28 vjeç, një person me rekorde kriminale, që njëhej dhe me nofkën “korçari”.

Njoftimi i policisë:

Në vijim të veprimeve për zbardhjen e ngjarjes së ndodhur mesditën e djeshme, në lagjen “Emin Matraxhiu”, Elbasan, ku gjatë një konflikti të çastit mes dy drejtues automjeteesh u përdorën dhe armë zjarri, falë veprimeve të shpejta hetimore dhe profesionale u bë e mundur zbardhja e ngjarjes, vënia në pranga e njërit prej autorëve dhe shpallja në kërkim e një tjetër autori. Si rezultat i veprimeve hetimore të thelluara, nën drejtimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, nga specialistët për Hetimin e Krimit kundër Personit në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan u arrestuan në flagrancë shtetasit: F. F., 21 vjeç, banues në Elbasan, për veprat penale “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë e kryer në bashkëpunim dhe “Armëmbajtja pa leje”. E. C., 21 vjeç, banues në Librazhd, për veprat penale “Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës” dhe “Moskallëzim krimi”. Gjithashtu, si rezultat i këtyre hetimeve është shpallur në kërkim policor, për veprat penale “Vrasje me dashje” e mbetur në tentativë, e kryer në bashkëpunim dhe “Armëmbajtja pa leje” shtetasi A. C., 21 vjeç, banues në Elbasan. Vijon puna për kapjen e tij dhe për kapjen e autorit tjetër, shtetasi M. Q. Materialet hetimore i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Elbasan, për veprime të mëtejshme procedurale.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

Etiketa: atentat Elbasan korçari

TË NGJASHME

FOTO/ Ja kush ishte shënjestra e atentatit në Elbasan, 'korçari' që dyshohet se u plagos afër stadiumit

25 Nëntor, 2020

Dokumentet/ Si u urdhërua ekzekutimi i Enver Hoxhës kur ai të shkonte në Pezë, plani i atentatit që thuri "Grupi i deputetëve"

Dashnor Kaloçi | 21 Nëntor, 2020

Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË



VIDEO/ Pamjet nga aksidenti tragjik në Golem, trupi i motoristit merret me barelë...

30 Nëntor, 2020



Aksidenti me një të vdekur në Golem, policia: Në motor edhe një pasagjere, u dërgua në spitalin e Durrësit

30 Nëntor, 2020

Aksident i rëndë në Golem, furgoni përplasat me motorin në autostradë, ndërron jetë drejtuesi (EMRI)

30 Nëntor, 2020

"Nuk kemi asnjë përgjigje nga analizat", flet vëllai i pacientit që u hodh nga Covid2: I thash 'mos shko në spital', motrës i rrëfeu se ...

30 Nëntor, 2020

I infektuar me Covid-19, vlonjati tenton të kalojë Kakavijë, gjobitet me 700 mijë lekë


30 Nëntor, 2020

KATEGORIA VIDEO



VIDEO/ Pamjet nga aksidenti tragjik në Golem, trupi i motoristit merret me barelë...

30 Nëntor, 2020



Kur Haga shpallte të pastër luftën e UÇK-së 18 vite më parë/ Lirimi i Fatmir Limaj dhe pritja madhështore në Kosovë

30 Nëntor, 2020

Këngë nga e gjithë bota, çifti Janaqi propozojnë menunë me 2000 këngë për ndjekësit

30 Nëntor, 2020

30 Nëntor, 2020

"Gënjeshtra i shkon për shtat", Jorida Tabaku: Ja si Rama po i bën rrush e kumbulla taksat e shqiptarëve

29 Nëntor, 2020

"Tentuan të më digjinin të gjallë, gjeta dy shishe benzinë"/ 52-vjeçarja rrëfen divorcin: Ndihej e kërcënuar, kërkoj ndihmën e shtetit

30 Nëntor, 2020

Aksident në Berat/ Fuoristrada del nga rruga, për pak sa nuk përfundon në lumë. Shpëton mrekullisht shoferi (VIDEO)

29 Nëntor, 2020